

Toleranca bujare e Islamit dhe ndikimi i saj në jetën e myslimanit

Description

Islam not found or type unknown

Hamza Jusuf

Koha që po kalojmë është plot konflikte e rrëmuja, që kanë pjellë kudo revolta dhe shqetësim, termat arabë të të cilave janë fitne dhe haraxh. Sipas disa traditave profetike, të dy gjendjet e mësipërme pasqyrojnë situatën aktuale të komuniteteve dhe njerëzve në ditët që jetojmë. Ne, ndërkohë, nuk duhet që t'i anashkalojmë, apo t'i justifikojmë në kuadrin e Islamit. Nën dritën e ngjarjeve të fundit, tragjedia më e madhe qëndron në paraqitjen negative që i bëhet Islamit në të gjithë botën.

Le të marrim, për shembull, rastin e vrasjeve tragjike të disa kuzhinierëve budistë nga Nepali, në Bagdad, ngjarje që çoi në shkatërrimin e një xhamie 400 vjeçare në Nepal, vend ku muslimanët e budistët kanë bashkekzistuar paqësisht prej shekujsh. Të dy shkollat Maliki dhe Hanefi, e kanë pranuar tradicionalisht statusin e xhizje-s dhe dhimi-ut për besimtarët hindu dhe budistë. Studiuesi i shquar al-Biruni, është marrë gjerësisht dhe ka shkruar shumë mbi të dy subjektet, duke nxjerrë në pah nivelin e lartë të sofistikimit në traditat fetare të banorëve autoktonë të jugut të Azisë. Kësisoj është veçanërisht e dhimbshme tek sheh sjellje të tilla të dhunshme e kriminale, nga persona që pretendojnë të jenë besimtarë të zjarrtë muslimanë, ndaj miqve nga fetë e tjera që kanë ardhur në vendin e tyre. Dhe për më tepër kur kjo ndodh për të vetmen arsye, se ata i përkasin një feje që ka pushtuar zemrat e popujve të Lindjes. Në këtë situatë koncepti i *samaha*-s (tolerancës), nuk ka qenë kurrë më i rëndësishëm se në këto çaste në historinë tonë të gjatë si një komb fetar.

Çfarë është Samaha

Arabishtja është një gjuhë e thellë dhe shumë e ndërlikuar. Në fakt janë pikërisht ndërlikimet e brendshme të kësaj gjuhe që çuan një orientalist në përfundimin se “arabishtja ka një ngjashmëri shumë më të madhe (në krahasim me hebraishten) me gjuhën origjinale semitike”. Arabishtja ka ruajtur shumë nga gjuha semitike, çka shfaqet në periudhat e saj kuranike, në universin e pamat semantik dhe në sistemin tepër të strukturuar të degëzimeve (ishtikak). Shumë gjuhëtarë janë të mendimit se gjuhët e humbin shumëllojshmërinë dhe kompleksitetin (sa'a), ndërsa evoluojnë. Për shkak të ruajtjes së arabishtes, ku gjuha ishte në thelb “e ngrirë” në atë kohë si gjuha e Zbulesës, ajo mbeti në formën kuranore dhe kjo dëshmohej edhe nga filologë e studiues që nuk ia atribuojnë këtë cilësi madje, as greqishtes së vjetër, as hebraishtes biblike. Ruajtja e fjalorit të saj dhe saktësisë së domethënies, siç na ka mbërritur në ditët tona përmes poezisë dhe prozës para-islame, na ka mundësuar kuptimet e sakta të termave islamë të përdorura në Kuran dhe nga vetë Profeti (Paqja e bekimi i Zotit qoftë me të). Kjo mrekulli shprehet bindshëm edhe në ajetin e Kuranit: “*Ne e zbritur Përkujtimin dhe Ne do ta ruajmë atë*”. Asnjë gjuhë tjetër nuk e ka një mbrojtje të tillë dhe dëshmia më e madhe e kësaj ruhet pikërisht në poezinë para-islame arabe dhe në fjalorët e hershëm arabë, të cilët janë të pakrahasueshëm me ato të gjuhëve të tjera për sa i përket lashtësisë. Leksikologët debatojnë

në lidhje me një numër të madh fjalësh që ekzistojnë si në tekstet e Testamentit të Vjetër, ashtu edhe atij të Ri. Ndërsa hulumtojnë, ende një numër i madh fjalësh ka mbetur i pashpjeguar. Ndërkohë në lidhje me termat e përdorura në Kuran ekzistojnë vetëm kundërshti për sa i përket kuptueshmërisë ose dhënies së më shumë kuptimeve një fjale të vetme.

Samaha ose asmaha përdoret “për të shfaqur bujari dhe fisnikëri” (*ata an karamin ua sakha*). Ideja e tolerancës rrjedh nga forma e katërt bazë e samaha-s, terminologjia e së cilës është “të jesh i mirë me dëshirat e të tjerëve” (uafeka ala al-metlub). Në Mu xham mekajis el-lugha, filologu Ibën Faris thotë: “*Rrënja smh nënkupton kënaqësi dhe lehtësi*” (tedulu madda smh ala mana es-salasa uas-suhula).

Salasa në arabisht nënkupton “dashamirësi, lehtësi dhe fleksibilitet” (inkijad). Profeti ka thënë: “Besimtari ka natyrë të qetë dhe të këndshme; nëse udhëhiqet, ai të ndjek” (El-mu'min hajin lajin idha kida inkada). Arabët thonë: Bisha u zbut pas egërsisë” (Asmaha an-dabba bade istis aba y lana ve ankada). Et-tesmih do të thotë “udhëtim i lehtë” (es-sajru as – sahl). Kuptimi i al-hanefije es-sambha është “feja pa asnjë lloj ndrydhjeje (dajk) në të”. “Thelbi i samaha-s është “një sjelljeje e lirshme ndaj jetës dhe të tjerëve që nuk ka vend për ashpërsi, intolerancë apo fanatizëm.”

Edhe pse koncepti i tolerancës në botën e sotme është një koncept evropian – për shembull ne na është mësuar “të tolerojmë” personat që janë “të ndryshëm” nga ne – është e lehtë të vihet re se si arabët, duke kërkuar një ekuivalent të fjalës në arabisht kanë gjetur fjalën tesamuh, si ekuivalente të termit evropian “tolerancë”. Është e rëndësishme të vihet re se arabishtja moderne është ndikuar shumë nga anglishtja dhe frëngjishtja, për shkak të fluksit të madh të ideve të muslimanëve modernë që jetojnë në këto vende. Një fenomen i tillë vihet re lehtësisht te studiuesit e shkretëtirës së Mauritanisë, të cilët pavarësisht njohjes së përkryer të arabishtes klasike, e kanë shumë të vështirë që të kuptojnë terminologjitë e reja të gazetave të përditshme të botës arabe. Mbeta veçanërisht i çuditur, kur mësuesi im, Murabit el-Haxh, që kishte shkruar një koment mbi Elfije te Ibën Malit, një tekst i sofistikuar ky me një gramatikë arabe që njihet në Mauritani për përkryerjen e tij, teksa po i tregojta një artikull gazete në të cilin flitej për të më pyeti: “Ç’gjuhë është kjo?” Kur i thashë se ishte arabisht m’u përgjigj: “Po, por jo arabishtja që njoh unë”

Besoj se koncepti që njihet në arabishten moderne për samaha, është më shumë se çdo koncept tjetër i lidhur me atë evropian. Ironia qëndron në faktin se koncepti bazë i tolerancës fetare në Evropë është një rezultat i drejtpërdrejtë i politikave otomane në Evropën Lindore ndaj të Krishterëve, Protestantëve dhe Unitarianëve. Ka qenë një princ unitarian nga Transilvania, i cili nën pushtetin Portës së Lartë Otomane i hapi rrugën fundit të luftërave fetare në Evropë. Të vjen për të ardhur keq tani, kur sheh se dhurata e çmuar që Islami i dha Evropës, po përpiqet për mbijetesë pikërisht në tokën nga ajo lindi, prej së cilës Islami lulëzoi.

Në botën muslimane, ideja e tolerancës në përdorimin aktual, nuk ka qenë e përhapur. Sot toleranca është sinonim i fjalës “pranueshmëri”. Në Perëndim, një person tolerant është ai që pranon thujse çdo gjë, me kusht që të mos ketë të bëjë me vrasjen, vjedhjen ose krime të tjera serioze. Në Perëndim tolerohen edhe gjëra të tilla jo-të moralshme si konsumimi, pornografia etj. Ndërkohë ky kup-tim i fjalës tolerancë, nuk është i përhapur në vendet muslimane, megjithëse ka përpjekje të vazhdueshme për të rrënjosur këtë pikëpamje, tek njerëzit.

Për të kuptuar, sensin e vërtetë të tolerancës në botën islame, duhet të kapim fillimisht kuptimin semantik të fjalës. Ekzistojnë disa terma që sillen rreth samaha-s, secila prej tyre shpalos një aspekt të

vetë konceptit.

Fusha semantike

Në universin islam të diskutimit, samaha, është e lidhur me termat e mëposhtëm: *tas'hil, tesjir, xhud, sakha, keram, lin, shahama, safah, afw dhe hilm*. Dy termat e parë kanë lidhje të ngushtë: tashil (të zbusësh) dhe Tasjr (të lehtësosh). Tas'hil, vjen nga fjala rrënjë sahl që është një lloj terreni që arabët e preferonin ndaj gjithë të tjerëve. Ai është i lëmuar, mbi të mund të kalërosh me lehtësi. Arabët shprehin dashurinë e tyre për këtë lloj terreni në përrshëndetjet më të ngrohta që i rezervojnë mikut: "Ehlan ve sehlen" që do të thotë: "Ke gjetur një familje në udhëtimin e lehtë". Tejsir është një prej fjalëve më popullore të lidhura me samaha-n. Jusr, është "lehtësi, lehtësim). Është pikërisht çka Zoti do që feja të jetë për njerëzimin: "Juridu bikum el-Jusr, ve la juridu bikum el-usr". (Ai kërkon lehtësi e jo vështirësi për ju). Ushr do të thotë vështirësi, që është një lloj marrëdhënieje. (Të dyja fjalët ndajnë gërmat sin dhe ra, por ndryshojnë në germën fa: "ain dhe ja". Ja, një fjalë e shenjtë: "Lehtësoni, mos vështirësoni" (Jasiru ve la tu'assiru"). Të pesë parimet e arta të jurisprudencës islame lidhen me konceptin e samaha-s , duke e ilustruar edhe më tej idenë se Islami është (një fe e moderuar" al hanafiyya as-samaha).

Parimi i Parë është "Punët përcaktohen nga qëllimet dhe synimet" (El-umur bi-mekasidiha). Qëllimi përfundimtar i gjithë ligjit të shenjtë është sipas studiuesve tanë: "Përftimi i përfitimit dhe shmangia e dëmit" (Jalb el-mesalil ve dar'i el-mefasid). Duke qenë se shqetësimi kryesor është përfitimi njerëzor, çështjet që shqetësojnë individët dhe shoqëritë do të konsiderohen gjithmonë me idenë e lehtësimit të probleme njerëzore.

Parimi i Dytë është "Dëmi duhet të ndreqet" (Ed-darar juzal). Ky parim gjithashtu, flet për nevojën e lehtësimit të çështjeve njerëzore, si individuale, ashtu edhe personale.

Parimi i Tretë është: "Zakonet marin formën e një status ligjor" (el-ada muhakkema). Ky parim funksionon duke njohur diferencat në natyrën njerëzore e kësisoj është i lidhur me samaha-n.

Parimi i Katërt, "Siguria nuk mund të rrëzohet nga dyshimi" (el-mashakatu texhclub et-tejsir). Lehtëson shumë veprime njerëzore që mund të dëmtohen nga dobësitë njerëzore.

Më në fund Parimi i Pestë është: "Vështirësitë kërkojnë lehtësim" (el-meshakatu texhclub et-tejsir). Ky parim përmbledh thelbin e samaha-s. Të gjithë parimet e sipërpërmendura dhe shumë të tjera që i pasojnë, bazohen në idenë e lehtësimit dhe ruajtjes së lidhjeve njerëzore, parim të cilit i përmbahet ligji i shenjtë.

Bujaria është një aspekt tjetër i samaha-s, që në thelb është një mjet me të cilin një person lehtëson dikë tjetër, duke krijuar mes tyre lidhje të forta. Bujaria është një lehtësim me veten dhe pronën. Arabët thonë: "*Bujaria është ajo që është e gatshme*" (El-xhud bil mevjud). Kjo mbart një aspekt të thellë të samaha-s. Qoftë edhe një buzëqeshje e vetme është një akt bujarie. "Një buzëqeshje që i jep vëllait është një akt dashurie", ka thënë Profeti. Bujari është gjithashtu, edhe një fjalë e mirë. Islami e nxit këtë lloj samaha-je, që është e mundur të ushtrohet nga të gjithë, si nga të pasurit, ashtu edhe nga të

varfrit. Në fjalorë gjejmë dy fjalë që japin kuptimin e këtij aspekti të bujarisë në samaha: xhud dhe sakha.

Sipas Ebu Hilal el-Askari në el-Furuk el-lughavije, dallimi mes të dyjave është se sakha është një lloj bujarie, përmes së cilës njeriu vepron lehtësisht me njerëzit që i kërkojnë ndihmë (jelinu el-insan indes-su al) dhe kështu ai i lehtëson nevojat e vështirësitë e atyre që i kërkojnë ndihmë. Xhud, nga ana tjetër është bujaria që rrjedh nga një person, edhe në rastin kur kjo nuk i kërkohet. Për këtë arsye Zoti konsiderohet Xheuad, por jo Sakhi për bujarinë e tij që buron pa ia kërkuar kush. Kështu ai që karakterizohet nga samaha është edhe bujar, kur askush nuk ia kërkon një gjë të tillë, zemërdhembshur dhe i gatshëm kur i kërkohet ndihmë.

Një tjetër term është lujuna, i cili nënkupton “lehtësi, butësi dhe xhentilesë”. Profeti ka thënë “Besimtari është xhentil dhe i butë” (El-mu’minu hajinun lejinun). Kjo cilësi është një aspekt i samaha-s. Kurani thotë: “Ishte një akt mëshire nga Zoti që ju u bëtë xhentilë (të butë) për ta, dhe nëse do të kishit qenë të ashpër e zemërgurë, ata do të kishin ikur prej jush. Kështu që falini, kërkon falje për ta (prej Zotit tuaj) dhe këshillojini në çështje të rëndësishme).”

Në komentin e tij për vargjet e mësipërme Imam al-Bursaui thotë: Përdorimi i pjesëzës ma para fjalës “mëshirë” (rahma) është për t’ia shtuar kuptimin mëshirës. Me fjalë të tjera “...për shkak të mëshirës së madhe (rahma adhima) të Zotit.” Kjo mëshirë është qëndrimi xhentil i Profetit ndaj njerëzimit. (Ai) i trajton ata me keqardhje dhe kujdes, edhe pse ata shpesh e trajtojnë me pashpirtësi, ashpërsi e mosbindje, dhe shpesh i kthehen Zotit në armiq.

Më tutje kuptimi i “ashpër dhe zemërgur” (fadhan ghalidh el-kalb), shfaq dy cilësi që mungojnë në karakterin e Profetit: mënyrat e këqija dhe ashpërsia. Një njeri mund të ketë mënyra të mira, por një zemër të pamëshirshme, por mund të ketë edhe mënyra jo shumë të mira sjelljeje e njëkohësisht një zemër të mirë. Profeti kishte një karakter të pamëkatë dhe gjithashtu një sjellje shumë të dhembshur dhe zemra e tij ishte e mbushur nga mëshira.

Imam al-Bursaui ka thënë për Profetin: “Si do të mund ta kishin ndjekur dhe adhuruar njerëzit Profetin në rast se ai do të kishte qenë zemërgur dhe i pamëshirshëm? Përse duhet ta kishin ndjekur, apo t’i ishin bindur? Ëmbëlsia e të folurit, shpesh ka një efekt më depërtues në zemër (enfad-hu fil-qulub) dhe përmes kësaj mënyre arrihet më shpejt te një përgjigje apo një bindje. Për këtë arsye Zoti e urdhëroi Moisiun dhe Aaronin që të shkonin tek Faraoni e t’i drejtoheshin me fjalë të buta (Idhheba ila Firaun innahu tagha fe qule mlahu qaulen lejin). Megjithatë duhet të kemi parasysh se xhentilesa dhe keqardhja duhet të përdoren në rast se një gjë e tillë nuk çon në braktisjen e të drejtave hyjnore ndaj njerëzve. Në rast se xhentilesa nuk i bën nder të drejtës hyjnore, atëherë ajo nuk është e lejueshme.

Për shembull, Zoti thotë: “O Profet, lufto kundër hipokritëve dhe tregohu i ashpër ndaj tyre. Vendi i tyre është ferri, çfarë destinacioni i mjerë!”.

Në lidhje me dënimin për shkelje kurore, Zoti thotë: “Tradhtarët dhe tradhtarët e bashkëshortësisë duhet të goditen me 100 kamxhikë, dhe mos e lejoni keqardhjen për ta t’u mposhtë nëse besoni te Zoti dhe te Dita e Fundit”.

Në analizën përfundimtare Kurani bën thirrje për një qëndrim të ndërmjetëm mes braktisjes dhe ekzesit (ifrat dhe tefrit), të cilat janë të dyja të dënueshme. Virtyti i vërtetë qëndron në linjën mes të dyjave, kështu që ka raste kur duhet përdorur xhentilesa, e raste të tjera kur duhet përdorur ashpërsia për të

arritur një drejtpeshim të përkryer mes ekstremeve. Pikërisht kjo është edhe rruga e drejtë (sirat el-mustekim). Për këtë arsye Zoti shpreh moderim në vargjet e mëposhtme, “Ne ju kemi bërë një komb të moderuar” (Ukedhalike ja alnakum umeten vasaten). Duhet ditur se qëllimi i plotë i Zbulesës dhe roli i lajmëtarit është që ta bëjë njerëzimin të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që ka. Ky qëllim nuk do të realizohet kurrë nëse zemrat nuk do të drejtohen për nga lajmëtari dhe mendja nuk do të ndjejë ndikimin e tij dhe vetë lajmëtari nga ana e tij nuk do të jetë fisnik dhe mëshirëplotë (kerim ve rrahim). Ai i ka falur gabimet e sjelljes së tyre. Më së fundi Imam al-Bursaui na rrëfen një fakt tragjik në lidhje me studiuesit e Islamit të një periudhe të mëvonshme: Nëse lajmëtari do të ishte zemërgur, njerëzit do t’i ishin larguar dhe për këtë arsye imamët dhe studiuesit e fesë duhet të ndjekin Profetin në këtë drejtim. Impenjimi fetar i njerëzve është i mirë në rast se ata që i prijnë si së jashtmi, ashtu edhe së brendshmi janë të mirë. Për fat të keq është një gjë e rrallë të gjesh shejhë që të karakterizohen nga sjellje me të vërtetë të bukura, nga sjellje të një etike të lartë, përpos rastiit kur bëhet fjalë për ata që mbrohen nga Zoti. Keram është një fjalë e thellë që nënkupton si “bujari, ashtu edhe fisnikëri”. Arabët para-islamë i bashkonin të dy konceptet. Një njeri fisnik ishte edhe bujar dhe një person bujar ishte edhe fisnik. Por keram do të thotë edhe dinjitet. Për shembull “Ne i kemi fisnikëruar ose bërë me dinjitet fëmijët e Adamit”. Kjo është një cilësi e rëndësishme e samaha-s, ideja e fisnikërisë në një akt bujarie.

Për sa i takon xhud, keram, sakha dhe samaha; të gjitha kanë të njëjtin kuptim. Samaha është sjellja e dikujt ndaj një tjetri me një qëllim pozitiv. Ajo është e kundërta e sak’hasa-s. Sak’hasa është një sjellje e ligë, krejtësisht e ndryshme nga keram, apo samaha.

Karakteristika e të qenit i lehtësuar, i relaksuar nënvizohet më poshtë si karakteristikë e një njeriu që mishëron samaha-n, në kundërshtim me tiparin e grindavecërisë. Kurani na kujton se të gjithë njerëzit janë një familje e vetme dhe se ata që janë më tolerantët, janë edhe ata më të ndërgjegjshmit ndaj Zotit.

Samaha dhe hapësira

Një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm i samaha-s, është ai i hapësirës (sa’s). Një nga kuptimet e shumta të samaha-s është “të lejosh” dhe koncepti i hapësirës mishërohet në të. Imam Firuzabadi thotë në Muhit: “Sigurisht në të ka hapësirë të madhe (inna fihi lamasmahan, ej mutesa’an). Ibën Manzuri thotë se mes kuptimeve që përdoren ka një fleksibilitet: “kaws samha), që është e kundërta e kazza. Sipas Ibën Manzurit kazaz do të thotë ajo që nuk relaksohet (le jenbesit), si për shembull fytyra e një njeriu të ngrirë, të ashpër. Ky koncept ka të bëjë me mungesën e hapjes dhe të bujarisë pa kufizim. Koncepti i kufizimit dhe heqjes së tij ndodhet gjithashtu, në rrënjët e ligjit të shenjtë të Islamit.

Profeti, e hoqi kufizimin dhe në shumë vargje ai thotë të mos jemi të kufizuar. Për shembull, Kurani thotë: “Dëgjoja me tolerancë atë që thonë dhe mos harro që Shërbëtori ynë David i forti, gjithmonë i kthehej, Zotit”.

Kurani thotë gjithashtu: “Ji i durueshëm, pasi durimi të vjen nga Zoti. Mos ndje keqardhje për ta dhe mos e humb toruan nga komplotet e tyre, pasi Zoti është me ata që kanë ndërgjegje dhe që bëjnë mirë.”

Përshkrimi që i bën Zoti besimtarit është: “ai që ka zgjeruar gjoksin e tij”. Në të kundërt ai që refuzon të vërtetën “është i ngushtuar në gjoks”.

Në përshëndetjen e mirëseardhjes arabët thonë: “Merhaban”, që do të thotë: “Gjithë hapësira ime është për ju”. Ideja e hapjes së vendit për të tjerët i ka rrënjët e ngulura thellë në samaha.

Kurani thotë: “Besimtarë kur ju kërkohet hapësirë jepeni atë. Edhe Zoti do t’ju bëj vend. Kur ju kërkohet të ngriheni, atëherë ngrihuni. Zoti është në dijeni për veprimet tuaja”. Ky është një shembull i madh i hadithit: “Besimtari është i butë dhe jo i ngurtë”, me fjalë të tjera samhun “në rast se bën atë ndaj së cilës ka detyrim”. Nëse i kërkohet të bëjë diçka nga e cila do të kenë përfitim të tjerët, ai duhet ta bëjë me dashuri.

Një herë, në Medinë, së bashku me eruditin Sheih Muhamed Muk-htar esh-Shinkiti, hyra në xhaminë e Profetit. I afroam besimtarëve që po luteshin dhe gjetëm pak vend të lirë. Kur Sheihu u përpoq të ulej, një burrë hungëroi: “Këtu ka shumë pak vend”. Sheihu iu përgjigj “Vendi i pakët nuk ndodhet në këtë sallë, por në zemër”. Kjo sqaron më së miri vargjet e mëposhtme arabe: *Armiqve edhe një fushë e madhe i duket e vogël ndërsa mes miqsh vrima e gjilpërës merr përmasat e një fushe të madhe.*

Muslimanët tradicionalisht janë persona shumë mikpritës, plot me bujari. Edhe arabët para-islamë i përçmonin ata që nuk i respektonin miqtë. Arabët i kanë mikpritur gjithmonë miqtë e tyre, duke u hapur jo vetëm shtëpinë, por edhe zemrën. Zemra e besimtarit është shumë e madhe për të gjithë ata që e kanë zemrën të mbujtur me besim. Kemi të bëjmë jo me një hapësirë fizike, por me një hapësirë psikologjike. Të bësh vend për ata, që ndoshta nuk kanë këndvështrimin tonë, apo që nuk mendojnë si ne është të jesh bujar – samih – liberal, i gjerë.

Profetin e pyetën: “Çfarë është besimi?” dhe ai u përgjigj: “Durim dhe bujari”. Durimi dhe bujaria e Profetit i kundërvihet vazhdimisht dhe i kundërpërgjigjet brutalitetit, vështirësive dhe persekutimit. Ai kurrë nuk ka lejuar që hakmarrja të mbizotërojë në vendimet e tij. Zoti është për falje. Ai thotë se edhe më të ligjtë duhet të falen: “O Zot, fali njerëzit e mi, pasi nuk e dinë se çfarë po bëjnë”. E gjithë kjo rrëfen për bujarinë e madhe të Profetit. Durimi dhe bujaria e Profetit bëri që shumë nga armiqtë e kundërshtarët e tij fillestarë t’i bashkoheshin.

Thelbi i samahas është karakteri i mirë. Profeti ka thënë: “Unë jam dërguar vetëm t’i përsos karakteret fisnikë”.

Ai mishëronte atë që është më fisnike tek një njeri. Profeti e pasqyroi këtë karakter jo përmes predikimeve, por përmes veprave konkrete. Miqtë dhe armiqtë e tij panë gjithmonë tek ai mishërimin e vlerave më të larta. Ai ishte Kurani i gjallë.

Samaha dhe marrëdhënia e saj me durimin dhe vetëkontrollin

Ndër të gjithë konceptet që kanë lidhje me samahan, askush nuk ka ndikim më të fuqishëm dhe jetëgjatë se sa vetëkontrolli (hilm). Është hanefije samaha ajo që zëvendësoi xhahilijen në Arabinë para-islame. Profeti është përshkruar si njeriu më me vetëkontroll. Fjala tolerancë në arabisht zakonisht përkthehet tasamuh me rrënjën smh. Një nga kuptimet në anglisht për “tolerancën”, është ai mjekësor: aftësia për të duruar pasojat e një ilaçi. Në arabisht fjala që përdoret është ihtimal nga rrënja hml. Fjalët hamala dhe halama lidhen në arabisht përmes një “derivati më të madh”. Hamala do të thotë “të mbash diçka”. Diçka fizike mund të mbartet, por mund të bëhet fjalë edhe për diçka psikologjike si në rastin “mbartës i Kuranit”, por mund të mbartet edhe sjellja e tjetrit.

Ka edhe fjalë të tjera interesante që vijnë nga hml të tilla si halama, që do të thotë “gjethnaja që rriten në zona të buta e të sheshta”. Një tjetër përcaktim i fjalës halama është kokrra e gjirit. Emërtohet kështu pasi nëna e përdor për të ushqyer foshnjën. Unë mendoj se kjo tregon lidhjen e thellë mes të ushqyerit me gji dhe zhvillimit të një intelekti të shëndetshëm. Një foshnje vetëm duke u kapur pas gjirit të së ëmës gjen paqe e qetësi, që është shumë e rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të fëmijës. Edhe vetë Kurani e këshillon të ushqyerit me qumësht gjiri. Vetëm pas kësaj foshnje do të kalojë në fazën tjetër pa ankthe dhe agresivitet. Në Perëndim ka një lidhje mes qumështit dhe mirësisë njerëzore që në arabisht shprehet me kalimin e hilm në halama. Personi që ka ushqyer Profetin me gji njihet me emrin Halime Sadija.

Një tjetër fjalë që rrjedh nga hlm është halim që do të thotë “ëndërrimtar”, duke iu referuar ëndrrave që shihen vetëm kur flihet në paqe. Imam Gazaliu thotë se Halimi është ai që sheh devijimet e fajtorëve, por që nuk i përgjigjet me inat, por me mëshirë edhe pse i dënon.

Kur disa mes Bijve të Izraelit i kërkuan Moisiut të shihnin Zotin, toka u tund. Moisiu tha: “Nëse do të kishe dashur, o Zot, mund të na kishe shkatërruar më parë. A do të na shkatërrosh tani për atë që bënë dritëshkurtrit tanë?”

Moisiu i kërkoi Zotit që të mos i dënonte të gjithë për mëkatet e disave. Me fjalë të tjera ai i tha Zotit: “Mos na dëno për mëkatet e të tjerëve”.

Falë Zotit ne jemi sot në këtë tokë dhe sipas Kuranit, Zoti është mëshirëplotë, e nëse ai do ta kishte gjykuar njerëzimin për të gjitha gabimet që ka bërë dhe bën, atëherë askush nuk do të kishte mbetur gjallë. Duke qenë se Zoti i trajton njerëzit në bazë të asaj se si ata i trajtojnë të afërmit e tyre, gjëja më e rëndësishme është të përmirësojmë sjelljen tonë ndaj të tjerëve, pra, hilmin dhe samahan.

Imami Maliku thotë se Jezusi, i biri i Maries ka thënë: “Mos fol gjatë pa sjellë ndër mend Zotin, pasi duke mos e sjellë ndër mend atë, zemrat do t’ju ashpërsohen”.

Sigurisht që një zemër e ashpër është larg nga Zoti. Mos i gjykoni mëkatet e të tjerëve sikur të ishit Zoti, por përkundrazi shihni mëkatet tuaja. Sigurisht që njerëzimi ndahet në dy kategori: ata që janë zhytur në mëkat e ata që nuk janë. Kini mëshirë për mëkatarët dhe lëvdoni Zotin nëse jeni liruar prej tyre. Imam Zakari thotë: Konsiderimi i mëkateve tona sikur të ishim shërbëtorë, do të thotë të kesh frikë se pronarët tanë do ta marrin vesh fajin.

Njerëzimi është, ose mëkatar e kësisoj në vuajtje, ose i pamëkatë e kësisoj në një gjendje pafajësie.

Të pasurit mëshirë për ata të torturuar nga mëkati, do të thotë të lutesh për ta (se mëkatet e tyre mund të ikin), do të thotë të mos ua ekspozosh mëkatet dhe t'i këshillosh me butësi e mirësi.

Ky është njëri aspekt i samahas dhe hilmit: një bujari shpirtërore për t'i trajtuar gabimet e të tjerëve me durim e mirësi. Askush nuk ishte më i madh në sa thamë më sipër se sa lajmëtari i Zotit.

Xhahilija dhe heqja e efekteve të saj

Para Islamit, shoqëria arabe konsiderohet sipas Kuranit si Xhahilije. Ja, përse quhet kështu sipas Kuranit: një këndvështrim e konsideron atë si një epokë injorance dhe kështu fjala xhahilije rrjedh nga rrënja e saj e parë që është fjala xhehl ose injorancë. Këndvështrimi i dytë është se kjo fjalë vjen nga xhahala, që do të thotë reagim jo i duhur ndaj ekzaltimit në situatën e dhënë. Në një varg poezie të Amr b. al-Bahilit gjejmë ilustrimin e këtij aspekti: *Vajzat morën qypa të zinj dhe të mëdhenj. Pastaj ata valuan dhe nuk gjetën më paqe*

Këtu poeti ka përdorur fjalën xhehl, si një metaforë për qypat që ziejnë dhe nuk paqëtohen kurrë, për shkak të ardhjes së vazhdueshme të miqve. Një nga aspektet më interesante të fjalës xhahilija në Kuran është se ajo përmendet vetëm 4 herë dhe gjatë secilës herë jep nuancën e plotë të kulturës xhahili, çka përfshin karakteristikat e kulturës dhe njerëzve xhahili.

Katër llojet e Xhahilijes

Lloji i parë është ai i kuptimit. Kurani thotë: Më pas qetësia zbriti mbi ju, duke mbuluar një pjesë tuajën, ndërsa pjesa tjetër ishte e shqetësuar me veten, duke supozuar në lidhje me Zotin gjëra të pajustificuara xhahilije.

Ata thanë, “A kemi të bëjmë me këtë çështje?”

Ata fshehin në zemrat e tyre atë që nuk do ta marrësh vesh kurrë.

Ata thonë: “Sikur të kishim të bënim me këtë çështje, nuk do ta kishim humbur jetën këtu”.

Ajo çka shprehet këtu është se xhahilija është një gjendje mendore. Mendja e xhahilit është e shqetësuar me veten deri në përjashtimin e të tjerëve dhe të besimit në Zot. Mendja e Xhahilit është injorante përkundërt Zotit dhe mendon keq për Zotin. Sipas një hadithi, Zoti shpall: Ajo çka shprehet këtu është se xhahilija është një gjendje mendore. Mendja e xhahilit është e shqetësuar me veten deri në përjashtimin e të tjerëve dhe të besimit në Zot. Mendja e Xhahilit është injorante përkundërt Zotit dhe mendon keq për Zotin. Sipas një hadithi, Zoti shpall: “Unë jam në opinionin e Shërbëtorit tim kështu që lëreni të mendojë për mua si të dëshirojë. Ai që mendon mirë do të gjejë mirë, ai që mendon keq do të gjejë keq”.

Xhahili e dëshiron kontrollin dhe nuk i pëlqen faktorët e tjerë që e imponojnë, edhe sikur të bëhet fjalë për persona më të kualifikuar. Komenti i bërë nga xhahili në vargjet e mësipërme “A kemi të bëjmë me këtë çështje” është në përgjigje të faktit se Profeti vendosi që të marrë mendimin e disa të tjerëve në lidhje me çështjen, nëse luftëtarët duhet të mbronin Medinën nga brenda, apo të dilnin jashtë e të përlesheshin me armikun. Mendja Xhahili është dyshuese. Në fund siç shihet edhe në vargje, mendja xhahili është e papjekur dhe ankthshore. Ankthi i tyre në lidhje me mënyrën e ecurisë së gjërave të çon në shqetësim personal. Fiksimi i tyre pas “ah, sikur të kishim vepruar kësisoj”, tregon se ata mendojnë që e shkuara është e pariparueshme. Profeti ka thënë: “Mos thuaj kurrë “sikur” , pasi kjo shprehje i hap derën Shejtanit”.

Lloji i dytë i xhahilijes është ai i organizimit shoqëror, ose i komunitetit. Për shkak se mendja e xhahilit është në një gjendje çekuilibri, strukturat shoqërore dhe institucionet e reflektojnë këtë situatë. Periudha para-islame ishte një periudhë hakmarrjeje, tribalizmi, gjakderdhjeje, racizmi, uzurpimi, shtypjeje, dhunim i grave dhe të varfërve dhe arrogance. Njerëzit ishin kaq shumë të shkëputur nga natyra e tyre saqë bënë gjithmonë gjykime e merrnin vendime jashtë natyre. As samaha e as hilmi nuk ndikonin në marrjen e vendimeve të tyre.

Lloji i tretë i xhahilijes ka të bëjë më shumë me gratë, edhe pse jo vetëm me to. Gratë xhahile dilnin dhe ekspozoheshin në publik, për t’u treguar të gjithëve stolitë e tyre. E gjitha kjo për shkak se i përkisnin një kulture xhahili, ku natyra e vërtetë e gruas nuk respektohej, as çmohej. Kriza mes mashkullit dhe femrës xhahil ishte shumë e madhe. Sipas traditës të lindje vajzë ishte një zhgënjim i madh për prindërit. Vajza rritej si një objekt që më vonë do t’i dhurohej mashkullit. Sipas asaj kulture femra konsiderohej si inferiore ndaj mashkullit. Ajo duhej të rrinte vetëm mes zbukurimeve, të zbukurohej edhe vetë dhe këtë t’ua tregonte të tjerëve. Ndërsa sipas ligjit islam femra lejohet të zbukurohet, por vetëm për burrin e saj, ose brenda mureve të shtëpisë.

Ky obsesion për t’u zbukuruar për ata që janë jashtë, që është një tipar perëndimor, tregon se përpjekjet e grave ishin që të bëheshin tërheqëse për burrat e tjerë. Në burrin xhahil shfaqen dy karaktere kryesorë: njëri është refuzimi për të pranuar të vërtetën dhe një përgjigje ndaj kësaj situatë që reflekton një verbëri shpirtërore. Veprimet e tij reflektojnë shumë fanatizëm. Mashkulli është intolerant dhe hakmarrës ndaj atyre që e kundërshtojnë. Është një person që udhëhiqet nga pasioni . Nuk është tolerant dhe i gjerë. Ai i dorëzohet vetëm atyre që kanë një karakter të dhunshëm dhe këtë e bën nga frika dhe jo nga bindja.

Elementet e mësipërm përbëjnë kulturën xhahili dhe shoqërinë. Mungesa e bujarisë së shpirtit (samaha), durimit, tolerancës; e çon njeriun drejt humbjes së ekuilibrit dhe dominimit të tij nga cilësitë më të ulëta njerëzore.

Kreu Kasas i Kuranit përmban një përshkrim të mrekullueshëm të atyre që dëshirojnë të mos kenë cilësitë e xhahilit. Zoti i Lartësuar thotë: “I kemi fjalët që t’i mbërrijmë e t’ua kujtojmë. Atyre që u dërgojmë Librin, ata e besojnë dhe kur u lexohet ata thonë: “Ne besojmë në të, pasi është e vërteta e Zotit”. Atyre do t’u jepet shpërblimi dyfish për durimin dhe për shkëmbimin e së keqes me të mirën. Dhe kur ata dëgjojnë të flitet jo mirë u thonë të tjerëve: “Ju keni punën tuaj, ne kemi punën tonë. Paqja qoftë me ju”.

Këto vargje nënvizojnë cilësitë e atyre që kërkojnë të distancohen nga cilësitë që e bëjnë një person xhahil. Ja, cilat janë cilësitë e një personi të tillë:

1. Ai e refuzon të vërtetën, kur e dëgjon.
2. Nuk ka qenë një person i mirë para se ta dëgjonte të vërtetën dhe kësaj nuk e njeh atë.
3. Ai është i paduruar dhe i nxituar.
4. Ia kthen të keqes me të keq.
5. Merret me fjalë të kota.
6. Futet në punët e të tjerëve.
7. Është krenar që ka lidhje me njerëz të ngjashëm me veten.

Ky është njeriu xhahil dhe kultura e krijuar prej tij mbart këto cilësi.

Në mes të kësaj kulture erdhi Islami. Profeti Muhamed i refuzoi sjellje të tilla. Ai e ndryshoi konceptin e njerëzve nga një koncept egoist në një koncept bujar e altruist. Nisi të fusë kritere të rinj të gjykimit të njerëzve dhe futi idenë se njerëzit kanë lindur të barabartë.

Para erës moderne, askush si Profeti nuk është marrë me çështjen e barazisë njerëzore. Ai ka thënë: "Njerëzit lindin të barabartë. Të gjithë vijnë nga të njëjtët prindër dhe nuk duhet të kemi preferenca mes ngjyrave e racave".

Profeti gjithashtu futi tregtinë e ndershme dhe ndaloi çdo praktikë dinake e djallëzore, ai gjithashtu u dha shumë të drejta grave dhe shërbëtorëve e sidomos fëmijëve.

Profeti Muhamed ishte gjithashtu qenia e parë njerëzore që futi rregullat e drejta të luftës, njëra prej të cilave është mossulmimi i atyre që nuk marrin pjesë në luftime.

Ishte Ebu Hanife, një ekspert ligjor me origjinë perse që themeloi një shkollë ligjesh në Bagdad me qëllimet kryesore:

ndalimin e vrasjeve të grave,

fëmijëve,

të moshuarve,

të sëmurëve dhe personave të tjerë që nuk luftojnë.

Ai i futi këto rregulla në një sistem ligjor, por ndërkohë zanafilla ishin rregullat e dhëna nga Profeti Muhamed.

Profeti ndaloi çdo vrasje për hakmarrje, që ishte një akt i zakonshëm mes arabëve. Ajo që është e rëndësishme është se Kurani u paraqiti arabëve një tjetër ligj atë të Jezusit, birit të Marisë, i cili i nxit familjet e viktimave të falin vrasësit. Ky koncept i ri, i tronditi xhahilët dhe gjithë kulturën e tyre në shekullin e shtatë në Arabi. Ata që përfitonin më shumë nga ligjet xhahili ishin edhe armiqtë më të mëdhenj të Profetit dhe sigurisht që Profeti u mbështet më së pari nga vetë viktimat më të mëdha të ligjeve.

Një nga karakteristikat e njeriut xhahil, është se ai është i verbër. Ai ka një vetëbesim prej të marri në rrugën që ndjek në jetë dhe mendon se gjërat që bëjnë të tjerët nuk duhet t'i bëjë dhe anasjelltas. Por duke qenë i verbër harron mësimet e së shkuarës. Për shkak të arrogancës dhe krenarisë së sëmure, njerëzit xhahil nuk arrijnë të shohin mësimet e padrejtësive nga historia.

Sa për Islamin, ai është feja e tolerancës e zemërgjerësisë dhe Islami erdhi për të zëvendësuar këtë realitet të kalbur. Megjithatë sipas disa komentuesve të Kuranit, libri i shenjtë flet për një xhahilje të dytë që do të zëvendësojë cilësitë e Islamit dhe ato që solli Profeti. Sipas një komentuesi nuk mund të ketë një të "fundit", pa pasur një të "parë". Sipas tyre xhahilja e parë ishte ajo e periudhës mes Jezusit dhe Muhamedit. Imam Nesefti thotë në komentin e tij të Kuranit:

"Gjendja e një xhahilie të parë është ajo e mosbesimit dhe e korrupsionit në Islam".

Bota islame ka hyrë në një periudhë xhahilie të dytë. Janë të njëjtat karakteristika si ato të së shkuarës: sjellja e grave, shfaqja e tyre në vende publike të stolitura e të zbukuruara, zelli i tërbuar për nacionalizëm, tribalizmi, hakmarrja, mungesa e shikimit brenda vetes.

Xhahilia nuk mund të luftohet me dhunë dhe urrejtje, por duhet trajtuar me shqetësim dhe tolerancë. Për shumë kohë studiuesit dhe të parët e fesë ia kanë vënë fajin botës jo-muslimane. Së fundi, ne po fajësojmë për situatën tonë edhe Zotin. Sulmet e fundit në Perëndim ndaj sjelljeve muslimane janë të pajustificueshme, kur sulmet konsiderohen si mësimet të Profetit. E vërteta është se këto sjellje reflektojnë vlerat më negative ndaj të cilave Islami ka luftuar gjithmonë. Në vend që ne të njohim të metat e gabimet tona përgjigja që u japim perëndimorëve është hakmarrja. Edhe pse fetë e tjera ajo e krishterë dhe Judaizmi gjithashtu mësojnë tolerancë dhe falje, këto koncepte shihen rrallë e më rrallë në ditët e sotme.

Profeti Muhamed e këshilloi kombin e tij që të mos bëhet prë e inatit. Në librin e tij "Arti i Luftës", Sun Tzu shkruan rreth 3 mijë vjet më parë: "Zemërimi është armiku më i madh". Zemërimi është një përgjigje e verbër. Është një përgjigje prej Xhahili. Një besimtar e di shumë mirë se gjithçka është nga Zoti. Zoti ka thënë: "O shërbëtorët e Mi, unë ju vlerësoj në bazë të veprimeve tuaja. Kështu që të gjithë ata që gjejnë mirë le të falënderojnë Zotin dhe ata që gjejnë keq le të fajësojnë vetëm veten për këtë".

Jeta është një operacion hyjnor që i bëhet shpirtit, që heq kancerin e epshit nga zemra dhe besimi na e bën të mundur që ta durojmë çdo dhimbje paqësisht. Besimi, feja dhe dashuria janë dhuratat më të mëdha që Zoti i ka falur njeriut. Është shpresa prometeane që na bën të ecim përpara, pasi asgjë nuk është më e guximshme sesa ekzistenca e shpresës, kur gjithçka përreth duket e pashpresë. Vetëm

duke parë Zotin në botë në çdo gjë do të mund të jetojmë në paqe. Humbja e Zotit është humbje e cilësive më të mëdha njerëzore. Në këtë rast i kënaqur do të ishte vetëm Djalli.

Islami është i sulmuar sot dhe është detyrë e gjithë atyre që kanë një sens ndërgjegje të natyrës së tij sublime, që ta mbrojnë atë. Profeti ynë ka thënë: “Unë kam ardhur të përmbush një detyrë fisnike”.

Vetëm përmes mishërimit të vlerave më të mira të Islamit të zemërgjerësisë e tolerancës, komuniteti ynë mund të shpresojë që të rindreqë udhën profetike edhe njëherë. E kjo është një detyrë e denjë për çdo profet.

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi